

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE,
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM, SI DHE ARSYETIMIN E MOSNDARJES NË LOTE**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- “Upgrade Sistemet End of Life, Serverat dhe Pajisjet e Rrjetit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Pajisje elektronike – 31710000-6;
- Sistem elektronik i inteligjencës – 35721000-4.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 72.900.000 (shtatëdhjetë e dy milion e nëntëqind mijë) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – **Autoriteti Portual Durrës** – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, të ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve në shtojcën 7 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” dhe në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, të ndryshuar, nenin 40, pika 5 dhe nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë jo më të vogël se 100% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllëgëritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenet 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë”, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, ose ekuivalente, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- **ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente**, (e vlefshme) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO;
- **ISO/IEC 20000-1:2018 (ose ekuivalente)**, e vlefshme lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e

Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;

- **ISO 27001:2013 (Certifikimi për sigurinë e Informacionit) ose ekuivalente**, (e vlefshme) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Certifikatave përkatëse.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ofertues ne kete procedure, secili prej operatoreve ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO të renditura më lart, sipas zërave të shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë në akt marrëveshjen midis palëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e certifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike dhe në varësi të zërave përkatës të preventivit. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

Certifikimi ISO 9001 ose ekuivalent na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Certifikimi ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qënë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i

fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është tërësisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware);

Pikërisht paraqitja e këtyre ISO-ve tregon se, OE zbaton sistemet e manaxhimit në përputhje me këto standarte dhe rrisin performancën dhe besueshmërinë për cilësinë dhe garancinë e mallrave që do të furnizohen nga operatori ekonomik fitues. ISO duhet të jenë në emër të shoqërive dhe në objektet e këtyre çertifikatave duhet të jetë përfshirë objekti i prokurimit.

Certifikimi ISO 27001:2013 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rendësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Kjo vjen pasi në këte kontratë do ketë edhe furnizime të reja ashtu si edhe migrim të dhenash/mirëmbajtje e upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këte drejtim.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar, ku operatori ekonomik autorizohet për shitjen e pajisjeve hardware që do të ofertohen (me numer 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12). Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të autorizuar duhet të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Autorizimit nga Prodhuesi/ Distributori i autorizuar shoqëruar me dokumentin që verifikon lidhjen mes prodhuesit dhe distributorit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, si dhe në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar për mallrat e cituar objekt prokurimi, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar edhe gjatë periudhës së garancisë mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit/instalimit dhe mirëmbajtjes, me qëllim verifikimin e origjinës së mallrave dhe të dhënave të tjera të deklaruara.

Gjithashtu, kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë

autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës. Duke qenë se objekt i kësaj procedure prokurimi është ndërtimi i një sistemi të ri që duhet të ketë vazhdimësi për tek Autoriteti Kontraktor, Operatorët Ekonomike duhet specifikisht të paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar përkatës me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të drejta për të rishitur këto produkte, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të certifikuar që zotëron certifikatën PMP (Project Manager Professional-Profesionist për Menaxhim Projektesh) ose certifikuar në nivel ndërkombëtar për menaxhim projektesh, ose ekuivalent. Për këto duhet të paraqesin certifikatën përkatëse dhe duhet të jete në listepagesen e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për këtë kriter, gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës, kohëzgjatjes të saj dhe rëndësisë operacionale që ka sistemi, ku të gjitha këto duhet domosdoshmërisht të ndiqen nga një profesionist i kualifikuar në menaxhimin e projekteve nga fillimi deri në fund, në mënyrë që të minimizohet në maksimum risku i mosrealizimit të kontratës për arsye menaxheriale. Ky lloj certifikimi është standard i kërkuar gjerësisht, dhe garanton Autoritetin Kontraktor se OE ka kapacitetet menaxheriale, njohuri dhe ekspertizë të thelluar në menaxhimin e projekteve, kredibilitet profesional si dhe shërben si një pikë kontakti me AK-në gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT-së, gjatë fazës së implementimit të projektit, ose ekuivalent. Për këto duhet të paraqesin certifikatën përkatëse dhe duhet të jete në listepagesen e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për këtë kriter, gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës, kohëzgjatjes të saj dhe rëndësisë operacionale që ka sistemi, ku i gjithë shërbimi dixhital/informatik duhet të ndiqet nga një specialist për menaxhimin e shërbimeve IT. Në të njëjtën kohë kërkohet të ndiqet paralelisht mirëmbajtja hardware dhe software e strukturës.

Për këtë arsye nevojitet 1 specialist ITIL ose ekuivalent. Ky lloj certifikimi është standard i kërkuar gjerësisht, dhe garanton Autoritetin Kontraktor se OE ka kapacitetet menaxheriale, njohuri dhe ekspertizë të thelluar në menaxhimin e shërbimeve IT, kredibilitet profesional si dhe shërben si një pikë kontakti me AK-në gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi, për implementimin e teknologjisë në pajisjet “**SERVER**” të ofertuar, ose ekuivalent.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për këtë kriter duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit janë edhe pesë pajisje Server është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën dy specialistë të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi përkatës për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të serverave të rinj si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato gjatë kohës së garancisë.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi, për implementimin e teknologjisë në pajisjet “**STORAGE**” të ofertuar, ose ekuivalent. Per kete duhe te paraqese certifikaten perkatese dhe duhet te jete ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për këtë kriter, duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit janë edhe dy pajisje të nivelit Data Storage, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij specialistë të paktën një specialistë të certifikuar nga prodhuesi në nivel profesional për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë të pajisjeve së Data Storage. Në këtë mënyrë garantohe mi se zgjidhja e ofertuar nga OE të implementohet me sukses dhe do të garantojë funksionalitet të plotë, performancë optimale dhe do të mirëmbahet gjatë të gjithë kohëzgjatjes se kontratës.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi i pajisjeve “**SWITCH**” të ofertuar, ose ekuivalent. Per kete duhe te paraqese certifikaten perkatese dhe duhet te jete ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për këtë kriter, duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit janë edhe 14 pajisje SWITCH profesionale të rrjetit, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën dy specialistë të çertifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë të pajisjeve të switch dhe konfigurimin e tyre. Në këtë mënyrë garantoheci se zgjidhja e ofertuar nga OE do të implementohet sipas standardeve më të mira dhe do të kemi funksionalitet të plotë të rrjetit kompjuterik dhe mirëmbajtje gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialistë të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi i pajisjeve “**FIREWALL**” të ofertuar, ose ekuivalent. Per kete duhe te paraqese certifikaten perkatese dhe duhet te jete ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për këtë kriter, duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit është edhe një pajisje Firewall, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën një specialist të çertifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë të pajisjeve të switch dhe konfigurimin e tyre. Në këtë mënyrë garantoheci se zgjidhja e ofertuar nga OE do të implementohet sipas standardeve më të mira dhe do të kemi funksionalitet të plotë të sigurisë në rrjetin kompjuterik dhe mirëmbajtje gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

- Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar: Dokumentin që vërteton trajnimin e specialistit për suport teknik të lëshuar nga kompania prodhuese e FTR-së ose organizma të formimit profesional dhe listepagesat Formularët E-Sig 25 (3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur).

2.3.10. Operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike te ngarkuar ne SPE nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës.Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe web-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
- c. Nr. i faqes në katalog referuar Nr. Identifikues të artikullit të ofruar sipas listës i shënuar me një shenjë dalluse.
- d. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin katalogët/broshurë për të gjithë mallrat që do të ofertohen. Katalogët duhet të jenë të përkthyer noterizuar si dhe të markuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 germa c, si dhe në nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e ofertës teknike dhe katalogëve të paisjeve të sipërcituara i shërben Autoritetit Kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesmarrës me produktin/tet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK, pra qëllimi i këtij kriteri është vërtetimi nga ana e operatorit ekonomik se paisja që do të ofrohet i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor duke bërë krahasimin ndërmjet tyre.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

III. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre artikujve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për artikujt, objekt i kësaj procedure prokurimi (software per virtualizim, per backup, server, data storage, firewall, etj), janë vendosur në përputhje me nevojat e institucionit për të garantuar funksionimin e sistemeve dhe pajisjeve të reja si edhe zëvendësimin e pajisjeve ekzistuese.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme e saktë e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit pa e ndarë në lote

Autoriteti Portual Durrës është duke zhvilluar procedurën e prokurimit me titull "Upgrade Sistemet End of Life, Serverat dhe Pajisjet e rrjetit". Megjithatë, në përputhje me nenin 39, pika 1, të LPP "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe me nenin 42, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ky projekt nuk është ndarë në lote për arsyet e mëposhtme:

1. Kompleksiteti teknik: Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përfshin sisteme që janë ndërvartëse dhe që kërkojnë integrim të qëndrueshëm. Ndarja e kësaj kontrate në lote mund të sjellë rrezikun e moskompatibilitetit të sistemeve dhe të komplikojë menaxhimin efektiv të projektit.
2. Kostoja e menaxhimit: Ndarja në lote mund të rrisë ndjeshëm koston administrative dhe atë të menaxhimit të kontratës. Çdo lot kërkon monitorim dhe koordinim të veçantë, duke e bërë procesin më të kushtueshëm dhe më kompleks në mbikëqyrjen e projektit në tërësi.
3. Siguria dhe integriteti i të dhënave: Siguria është jetike në projekte që përfshijnë përditësimin e infrastrukturës TIK. Punimi me shumë kontraktorë mund të rrezikojë sigurinë e të dhënave, pasi çdo kontraktor mund të aplikojë standarde dhe protokolle të ndryshme të sigurisë, çka rrit rrezikun e sulmeve kibernetike dhe të shkeljeve të të dhënave.
4. Efikasiteti dhe kohezioni teknik: Një ofrues i vetëm siguron një qasje më të koordinuar dhe të unifikuar në zgjidhjet e TIK, duke minimizuar problemet që mund të lindin nga ndërveprimet midis komponentëve teknologjikë të ndryshëm, situatë që mund të ndodhë nëse punohet me ofrues të ndryshëm për çdo lot.
5. Kohëzgjatja e projektit: Një projekt i ndarë në lote mund të zgjasë kohëzgjatjen totale të zbatimit për shkak të nevojës për koordinim dhe integrim të ndërlikuar të pjesëve të ndryshme të projektit që dorëzohen nga kontraktorë të ndryshëm.

Bazuar në këto argumente, është konkluduar se procedura për përditësimin e infrastrukturës TIK në Autoritetin Portual Durrës nuk është e përshtatshme të ndahet në lote. Ky arsyetim do të përfshihet në dosjen e tenderit për të garantuar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave të kuadrit ligjor e nënligjor mbi prokurimin publik.